



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS FUSHË KOSOVE

Numri i lëndës: 2022:024128  
Datë: 30.04.2024  
Numri i dokumentit: 05644383

**P.nr.285/22**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NE PRISHTIË – DEGA FUSHË KOSOVË** - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, sipas Gjyqtares Laura Hoti Statovci, në lëndën penale të akuzuarave A. B. dhe H. H. për shkak të veprës penale Sulmi nga neni 184 par 1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.316/22 të datës 08.02.2022, në seancën e shqyrimit fillestar publik të mbajtur me datë 29.04.2024, në pranin e Prokurorit të Shtetit Besnik Jakupi dhe të akuzuarve A. B. dhe H. H., me datë 29.04.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 30.04.2024 përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

Të akuzuarat:

1. A. B., e bija e F.... dhe nëna E..... e lindur me ....., në S....., me vendbanim në F.... K..... L.... nr. ...., me numër personal ....., të dhëna këto të vërtetuar nga dokumenti i letërnjoftimit të lëshuar nga MPB, ka të kryer shkollën fillore, e martuar, nënë e gjashtë fëmijëve, e gjendjes së dobët ekonomike, Rome Shtetas i Republikës së Kosovës dhe
2. H. H, e bija e Xh..... dhe nëna S..... e lindur në vitin ..... në Sh..... me vendbanim në F.... K..... L.....nr., ka të kryer shkollën fillore, e martuar, nënë e dy fëmijëve, e gjendjes së dobët ekonomike, Rome, Shtetase e Republikës së Kosovës, të dhënat të konfirmuara nga e pandehura në procedurë pasi e njëjta nuk posedon dokumente identifikimi.

**JANË FAJTORE**

Sepse:

Me datë 22.12.2021 rrëth orës 17:20, në L....., në F.... K....., e dëmtuara H. K., e cila kishte shkuar tek shtëpia e të pandehurës A. B., dhe pas një konflikti që kishin pasur mes vete, e pandehura A. B. me dashje e ka sulmuar fizikisht duke e kapur përfytë të dëmtuarën H. K. pastaj nga shtëpia del e pandehura H. H., e cila edhe kjo e sulmon të dëmtuarën H. .K duke e goditur disa herë me duar në gojë.

- Me këtë secila veç e veç kanë kryer veprën penale *Sulmi* nga neni 184 paragrafi 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të nenit të lartcekur dhe neneve 4, 7, 8, 9, 10, 17, 21, 38, 69, 70, 71, 81 dhe 82 të KPRK-së neneve 240, 241, 242 par. 1 dhe 6, 358, 359, 360, 361 dhe 364, 498, 499 të KPPRK-së, të akuzuarave i shqipton:

## VËREJTJE GJYQËSORE

Te akuzuarave A. B. dhe H. H. i bëhet me dije se kanë kryer vepër penale të dëmshme dhe nëse serish kryen ndonjë vepër të tillë, gjykata do të shqiptoi sanksionin penal.

Obligohen të pandehurat secila veç e veç që në emër të shpenzimeve të procedurës gjyqësore të paguaj shumën prej 20 (njëzet) Euro në emër të paushallit gjyqësor, si dhe shumën prej 20 (njëzet) Euro në emër të kompensimit të viktimate të krimtit, të gjitha këto në afat prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

E dëmtuara H. K. për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në procedurë civile.

### A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur Aktakuzë PP/II.nr.316/22 të datës 08.02.2022, ndaj të akuzuarave A. B. dhe H. H. për veprën penale Sulmi nga neni 184 par 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së, 06/L-074).

Gjykata, në këtë çështje penalo juridike ka mbajtur seancën e shqyrimit fillestar me datë 29.04.2024, në prani të Prokurorit të Shtetit Besni Jakupi dhe të pandehurave A. B. dhe H.H. ku të njëjtat u njoftuan me të drejtat e tyre, me aktakuzën dhe provat kundër tyre.

Pas leximit të aktakuzës nga prokurori të pandehurat u deklarua se e pranojnë fajësinë për veprat penale për të cilat akuzohet sipas aktakuzës.

Pas deklarimit të pandehurave dhe mendimit të prokurorit se nuk e kundërshtojë pranimin e fajësisë, Gjykata konstatoj se të pandehurit kanë pranuar fajësinë në mënyrë vullnetare dhe pa asnjë presion, të pandehurat janë të vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë, si dhe të gjitha kërkesat nga neni 248 par. 1 të KPPRK-së janë përmbrushur. Ashtu që gjykata aprovon deklarimin për pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve.

Duke pas parasysh se gjykata ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarave dhe ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrëthanë nga neni 357 par.1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPPRK-së, si dhe faktin se janë plotësuar kushte nga neni 242 par. 6 lidhur me par. 2 të KPPRK-së, atëherë ne ketë çështje penale nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata pas deklarimit të akuzuarave se e pranojnë fajësinë në kuptim të nenit 242 par. 6 të KPPRK-së ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Me faktet e ofruara ne shkresat e lëndës, e po ashtu me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurave është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv te këtij aktgjykimi. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimit, rrjedh se në veprimet e të pandehurave A. B. dhe H. H. qëndrojnë të gjitha elementet e veprave penale për të cilat të njëjtit akuzohen sipas dispozitivit të aktakuzës.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se të akuzuarit e kanë kryer veprën penale me dashje, ndërsa gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrëthana të cilat do ta zgjedhë apo përfshirë janë përgjegjësin penale të tyre, kështu që të njëjtit janë penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe renduese ne kuptim te nenit 70 te KPRK-se. Kështu si rrethana lehtësuese për te akuzuarat, gjykata ka vlerësuar faktin se të njëjtët kanë treguar sjellje korrekte gjate shqyrtimit gjyqësor duke pranuar fajësinë, duke u ndier të përgjegjshëm për veprimet e tyre dhe duke shpreh keqardhje për veprën qe e kanë kryer. Të gjitha këto rrethana kjo gjykatë i ka pranuar si rrethana lehtësuese ne dobi të akuzuarve. Ndërsa si rrethanë rënduese gjykata nuk gjeti.

Andaj, duke vlerësuar këto rrethana, Gjykata ne kuptim te nenit 81 te KPRK-se te akuzuarit i gjykoj si ne dispozitiv te këtij aktgjykimit, me te cilin do te arrihet edhe qëllimi i dënimit.

Gjykata ka ardhur ne përfundim se dënim i shqiptuar te akuzuarave është ne përputhje me shkallen e përgjegjësisë penale te tyre dhe me intensitetin e rrezikimit te vlerave te mbrojtura te shoqërisë. Gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do te shërbej për arritjen e qëllimit te dënimit ne pengimin e te pandehurve ne kryerjen e veprave penale ne te ardhmen veçanërisht llojin e njëjtë të veprës penale, por ai do te ndikoj edhe si preventive e përgjithshme për personat tjerë qe te përbahen nga kryerja e veprave penale ne përputhje me nenin 38 te KPPRK-se.

Duke u bazuar ne nenin 449 par. 2 pika 2.6 dhe 452 par.1 te KPPRK-se si dhe në bazë të nenit 36 par.3 nën par. 3.1 të Ligjit për kompensimin e viktimate të krimtit nr.08/L-109, Gjykata ka vendosur për shpenzimet e procedurës penale në shumën e përgjithshme prej 40 €uro për secilën të pandehur.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 364 të KPPK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA FUSHË KOSOVË,  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM PENAL  
P.nr.285/22 datë 30.04.2024**

**Gjyqtarja e vetme Gjykuese**

**Laura Hoti Statovci**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë te drejtë të parashtrojnë ankesë në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të njëjtët. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.